

VENDIM
Nr. 269, datë 14.10.2022

MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 249, DATË 13.12.2021, “MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 111, DATË 26.4.2021, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË ‘E-VENTO SRL ALBANIA’ SHPK, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 32, DATË 4.2.2021, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË ‘E-VENTO SRL ALBANIA’ SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 84, DATË 17.7.2008, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 53, pikat 2 dhe 3, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1799/9 prot., datë 12.10.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rishikimin e vendimit nr. 249, datë 13.12.2021, “Mbi rishikimin e vendimit nr. 111, datë 26.4.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘E-Vento s.r.l. Albania’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 249, datë 13.12.2021, vendosi:

1. Të zgjasë me 12 (dymbëdhjetë) muaj afatin e plotësimit të kushtit të vendosur në pikën 3.1 (Studimi i Fizibilitetit), të vendimit nr. 111, datë 26.4.2021.

2. Të zgjasë me 9 (nëntë) muaj afatin e plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 3.2 dhe pikën 4, germat “a” dhe “b” (Leja e mjedisit, dokumentacioni pronësor dhe dokumentacioni përkatës vërtetues për realizimin e investimeve), të vendimit nr. 111, datë 26.4.2021.

3. Shoqëria “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k. të informojë/dokumentoje në ERE çdo muaj ecurinë e plotësimit të këtyre kushteve.

4. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me informacionin/dokumentacionin e përditësuar, sipas pikës 3, të këtij vendimi, apo aktet ligjore apo nënligjore të dala nga organet e tjera.

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 249/2021, me shkresën nr. 961/14 prot., datë 29.12.2021, dhe me shkresën nr. 167 prot., datë 24.1.2022, i kujtoi shoqërisë detyrimin për të informuar/dokumentuar në ERE ecurinë e plotësimit të kushteve të këtij vendimi.

- Në vijim dhe në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 249/2021, shoqëria me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 167/1 prot., datë 25.1.2022; nr. 167/2 prot., datë 23.3.2022; nr. 167/5 prot., datë 13.6.2022; nr. 167/6 prot., datë 5.7.2022; nr. 1360 prot., datë 21.7.2022; nr. 167/7 prot., datë 1.8.2022; nr. 167/8 prot., datë 12.8.2022; nr. 167/9 prot., datë 29.8.2022; nr. 167/11 prot., datë 14.9.2022; si dhe nr. 167/12 prot., datë 21.9.2022, ka depozituar dokumentacion, nga i cili rezulton, si më poshtë.

- Për sa i përket pajisjes me lejen e mjedisit, shoqëria ka bërë me dije, se pas pajisjes me VNM-në paraprake, për shkak të kompleksitetit të projektit dhe shtrirjes së madhe të tij, duhet t’i nënshtrohet procedurës për VNM-në e thelluar, për t’u pajisur me deklaratë mjedisore. Shoqëria ka dokumentuar në ERE realizimin e raportit të thelluar të ndikimit në mjedis. Në vijim shoqëria ka bërë me dije se ka bërë dhe aplikimin përkatës për t’u pajisur me këtë deklaratë.

- Sa më sipër rezulton se shoqëria “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k. nuk e ka plotësuar ende këtë kusht, por është në proces për t’u pajisur me deklaratën mjedisore përkatëse.

- Për sa i përket dokumentacionit pronësor, shoqëria ka njoftuar se sipërfaqja e pronave e azhurnuar nga shoqëria, është dorëzuar pranë bashkive për t’u konfirmuar.

- Sa konstatohet në udhëzimin nr. 1/2016, konkretisht pika 10, germa “h”, përcaktohet, se pjesë e dokumentacionit për të marrë në përdorim një sipërfaqe të caktuar nga fondi pyjor kullosor publik është dhe leja mjedisore. Sa më sipër, për të vijuar me plotësimin e këtij kushti, shoqëria “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k. duhet të pajiset fillimisht me deklaratën mjedisore.

- Për sa i përket realizimit të investimeve për zhvillimin e projektit, shoqëria ka depozituar një marrëveshje investimi ndërmjet saj dhe shoqërisë “G.P.G. Company” sh.p.k., me objekt bashkëpunimin mes dy shoqërive për të mundur realizimin e projektit të ndërtimit të parkut eolik, ku shoqëria “G.P.G. Company” sh.p.k. merr përsipër të mbulojë të gjitha shpenzimet e nevojshme të paraqitura për realizimin e projektit

- Gjatë raportimeve të saj periodike, referuar dhe vonesave të shkaktuara përtej vullnetit të shoqërisë, kjo e fundit ka kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 249/2021, me 6 muaj.

- Duke marrë në konsideratë përpjekjet e saj për të plotësuar kushtet e vendimit nr. 249/2021, raportimet periodike, ku janë pasqyruar e dokumentuar vonesa që nuk varen nga shoqëria për sa i përket pajisjes me deklaratën mjedisore, si dhe faktit që rinovimi apo lidhja e kontratave të qirasë varet nga marrja e deklaratës, vlerësohet të zgjaten afatet e plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 2 të vendimit nr. 249/2021.

- Gjithashtu, në kuadër të vlerësimit të përpjekjeve të shoqërisë në plotësim të këtyre kushteve, vlerësohet që t’i lihet asaj detyrimi për të depozituar në ERE, një progresraport me informacione çdo 3 (tre) muaj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 249, datë 13.12.2021, ndryshon si vijon:

“2. Të zgjasë me 3 (tre) muaj afatin e depozitimit të deklaratës mjedisore dhe me 6 (gjashtë) muaj afatin e depozitimit të dokumentacionit pronësor, duke filluar ky afat nga data 14.9.2022.”.

2. Pika 3 e vendimit nr. 249, datë 13.12.2021, ndryshon si vijon:

“3. Shoqëria “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., çdo 3 (tre) muaj një progresraport me informacion për investimet që do të kryejë, në kuadër të plotësimit të kushteve të sipërcituara.”.

3. Shoqëria “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k. të paraqesë në ERE, në mënyrë periodike, me data të rifreskuara, dokumentet që i nënshtrohen rinovimit të afateve.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti